



KOMUNIKATË

24.11. 2009

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e 68-të të radhës, është informuar për rrjedhën e procesit të numërimit në Qendren e Numrimit dhe të Rezultateve, për përgatitjet e Raundit të II-të të Zgjedhjeve dhe për furnizimin me material zgjedhor shtesë. Lidhur me aprovimin e rendit të ditës, kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, ka kërkuar që në rend të ditës të futet vendimi i KZAP-it për anulimet në 15 vendvotimeve. KQZ e ka futur në rend të ditës vendimin e KZAP- it.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me votim 9 për dhe 1 kundër, ka marrë vendim që sipas vendimit të KZAP-it A nr. 227/ 2009, të anulohen këto 15 vendvotime. Anulimi është bërë për komunën e Gjakovës (8 vendvotime), të Lipjanit (3 vendvotime), të Shtimes (2 vendvotime), në Malishevë (1 vendvotim) dhe të Shtërpce (1 vendvotim). KQZ ka vlerësuar që anëtarët e KVV-e të cilët kanë shkelur Kodin e Mirësjelljes të largohen nga KVV-të dhe të mos marrin pjesë në Raundin e Dytë të Zgjedhjeve. Me vendim, KQZ i ka larguar nga procesi zgjedhorë komisionerët e të 15 KVV-e të anuluar.

Në vazhdim të mbledhjes, kordinatori i QNR-së z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në me informacionet më të fundit për procesin e numërimit. Aktiviteti në QNR, në Hapësirën e Numrimit është fokusuar në procesin e vazhimit të numrimit të Fletëvotimeve me kusht për Kryetar Komune nga komuna e Suharekës, Prishtinës, Ferizajit, Fushëkosovës, Istogut, Prizrenit, Gjilanit, Mitrovicës, Vitisë, Malishevës dhe Skënderajt.

Ka përfunduar numërimi i materialit të vendvotimeve që kanë qenë në karantinë: VV 2717b/02r nga komuna e Vushtrresë, e që FPR-të për Kryetar Komune nuk ishin të numëruara; VV 1301x/03r nga komuna e Lipjanit, e ku FPR –të për Kuvendin Komunal nuk ishin të plotësuar; VV 2021a/02d kanë munguar FRK-të.

Z. Burim Ahmetaj, e ka informuar KQZ-në se QNR është në process të futjes së të dhënave nga FRD-të ndërsa, ka përfunduar procesi i futjes së të dhënave nga FPR-të dhe FRK-të nga rinumrimi i vendvotimeve. Një sasi e vogël e FR-ve është në auditim dhe, ka progres në këtë drejtim. Në karantinë nuk ka asnjë kuti të votimit me kusht, kurse kutitë janë duke u arkivuar. Gjithashtu, nuk ka asnjë material për t'u hetuar.

Z. Burim Ahmetaj, në vazhdim të raportimit nga QNR ka kërkuar nga KQZ që të lejojë alternativa për kompletimin e Formularëve të Përputhjes së të Dhënave për 5 vendvotime, pasi që FPR-të janë në rregull por që fizikishtë mungojnë. KQZ e ka aprovuar kërkesën e QNR-së që të bëhet zgjedhja për këto FPR, përmes marrjes së kopjeve të FPR-ve nga Komisionet Komunale Zgjedhore.

Në vazhdim të mbledhjes, Adnan Rrustemi nga Departamenti për Operacione Zgjedhore e ka informuar KQZ-në lidhur me përgatitjet që po bëhen për Votimin me Postë lidhur me Raundin e Dytë të Zgjedhjeve. Pas informacioneve të paraqitura, OVPP i ka rekomanduar KQZ-së që ta aprovoj kërkesën që materialet e votimit t'u dërgohen në mënyrë komplete 1806 votuesëve potencial për votim me Postë. Ky rekomandim, shtë bazuar në atë që përgatitjet të bëhen në mënyrë sa më efikase dhe, me kohë. KQZ e ka aprovuar këtë rekomandim.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e sotshme gjithashtu ka shqytuar edhe njoftimin për Furnizim me Material Zgjedhor Shtesë lidhur me Raundin e Dytë të Zgjedhjeve. KQZ ka marrë qëndrimet e nevojshme, konform përgatitjeve për balotazh më 13 dhjetor.